

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT ME  
OBJEKT “MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË  
FINANCIARE”, PËR PERIUDHËN 30.09.2013 - 31.12.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën 16.09.2013 deri 31.12.2014, si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 84, datë 30.06.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresën nr. 1217/13, datë 30.06.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar znj. Lindita Nikolla, Ministër i Arsimit dhe Sportit, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:**

1. Nisur nga kërkesat e Ligjit 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të projektligjit të ri, i cili është në fazën e shqyrtimit në Komisionet Parlamentare, theksojmë se misioni i Arsimit të Lartë përkufizohet edhe me kërkesat e përgatitjes së shkencëtarëve dhe kërkuesve të rinj, përmes mundësive të barabarta për t’u arsimuar, duke ndihmuar e asistuar në zhvillimin ekonomik e social, nëpërmjet konsolidimit të vlerave demokratike e qytetare. Nga auditimi i realizuar mbi këtë objektiv nisur edhe nga problematika e ngritur nga profesorë të respektuar të Universitetit të Tiranës dhe e debatuar gjerësisht mediatikisht, lidhur me miratimin e kotave për studime doktorale (cikli i tretë i studimeve), në IAL publike konstatojmë se që nga viti 2012 e në vijim, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nuk ka asnjë kuotë të miratuar për studime të ciklit të tretë duke **çuar efektivisht në bllokimin e studimeve të këtij niveli në mbarë vendin dhe drejtimin e tyre vetëm në një Institucion privat të Arsimit të Lartë.**

Ligji 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” në nenin 26 (pika 2) përcakton se “*Institucionet e arsimit të lartë ofrojnë programe të studimeve të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë vetëm në ato fusha, ku ato plotësojnë kriteret dhe përmbushin standardet shtetërore, në përputhje me këtë ligj*”. Ndërsa në nenin 34 (pika 4), përcakton “*Kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ministria e Arsimit dhe Shkencës formulon propozimin e saj pas konsultimit me Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe rekomandimet e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës*”. Pra kalojnë në miratim vetëm kuotat e pranimit në ***Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, duke e lënë të hapur pjesën e kuotave për Institucionet e Arsimit të Lartë private (për shkak se ligjvënësi nuk e ka konsideruar të mundshme hapjen e këtyre programeve në këto lloj institucionesh).***

Në vijim të kërkesës së ligjit, hapja e programeve për studime doktorale në Institucione Publike të Arsimit të Lartë është rregulluar në VKM nr. 864 datë 05.12.2007 dhe i referohet neneve 26 dhe 42 të Ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, ku në pikën 1 përcaktohet qartë që “***Institucioni publik i arsimit të lartë që aplikon për hapjen e programeve të studimit të doktoraturës duhet të jetë një universitet, akademi, Shkollë e Lartë Universitare, që provon se plotëson standardet akademike dhe infrastrukurore për të hapur ciklin e tretë të studimeve dhe për të organizuar ato...***”, ndryshuar me vendimin nr. 593 datë 18.08.2011 ku hapet tregun edhe për Institucione jo publike, kjo përmes heqjes së përcaktimit “publik” në pikën 1 të VKM nr. 864 datë

05.12.2007, "**Institucioni i arsimit të lartë që aplikon për hapjen e programeve të studimit të doktoraturës duhet të jetë një universitet, .... Shkollë e Lartë Universitare, që paralelisht aplikon për statusin universitet. Gjithashtu në këtë vendim mungon saktësimi që i bëhet nenit 26 pikës 2 të ligjit, që provon se plotëson standardet akademike dhe infrastrukturore për të hapur ciklin e tretë të studimeve dhe për të organizuar ato.** Ndërsa në pikën 2 të VKM 864, theksohet se për hapjen e programeve të studimeve të doktoraturës....., institucionet duhet të paraqesin kërkesën pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës bashkë me dokumentacionin e nevojshëm sipas kërkesave të kësaj VKM. Në pikën d cilësohet ..parashikimi për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoraturës, jo më i vogël se tre (pra ka përcaktuar kufirin e poshtëm duke e lënë kufirin e sipërm në dorë të institucioneve).

Konstatohet se aspektet ligjore të hapjes së ciklit të tretë të studimeve i janë nënshtruar ndryshimeve të herë pas herë drejt një tregu të liberalizuar si për nga institucionet që ofrojnë këtë cikël studimi ashtu edhe për numrin e studentëve që hyjnë në to, duke mos e shoqëruar këtë proces me instrumente të fortë monitorues, *trajtuar më hollësisht në faqet 138-152 të Raportit të Auditimit.*

**Për këtë është rekomanduar:**

1. Në kohën kur Ministria e Arsimit, është duke punuar për të bërë ndryshime në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe duke vlerësuar rolin që ky Institucion duhet të ketë në vendosjen, plotësimin dhe mbajtjen e standardeve të larta dhe unifikuese për këtë cikël studimi në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë në vend, inkurajojmë përcaktimin e qartë të kompetencave monitoruese të Ministrisë, duke synuar forcimin e rolit të këtij institucioni në mbarëvajtjen e programeve të ciklit të tretë të studimeve, i cili në gjykimin tonë fillimisht duhet të jetë cikël studimi me kohë të plotë. Të theksohet detyrimi për krijimin e një database të veçantë, të unifikuar dhe përditësuar ku të jepen të dhëna për udhëheqësit, temat e doktoraturave dhe reçencat, i cili të jetë publik dhe i aksesueshëm nga të gjithë të interesuarit.

2. Ligji duhet të ketë instrumente kontrolli publik të shoqëruara me identifikim/përcaktim përgjegjësie individuale dhe institucionale për proceset e fitimit/miratimit të titujve akademik, duke synuar rregullimin e plotë dhe afatgjatë të kërkimit shkencor dhe etapave/kushteve të përparimit në karrierën akademike.

3. Në ligj dhe në aktet nënligjore të përcaktohen kompetencat kufizuese të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, në të gjitha rastet kur konstatohen parregullsi apo nivel i ulët i plotësimin të standardeve të përcaktuara apo kritereve të detyrueshme të vendosura për çdo Institucion Publik apo Privat të Arsimit të Lartë, duke specifikuar qartë për çdo fazë të monitorimit llojin e kufizimit dhe masën e tij.

**Brenda muajit Gusht 2015**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

1. Nga auditimi u konstatua se nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe të Sporteve, deri në vitin 2012 është identifikuar regjistrimi i një numri të konsiderueshëm doktorantësh, për shkak të tendencës së një tregu të liberalizuar si për llojin e studimeve doktorale ashtu edhe për numrin e studentëve që hyjnë në to si dhe pamundësi e plotë e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik (sidomos në rrethe) me profesorë për të ndjekur udhëheqjet e punimeve doktorale, por nuk ka hapa konkrete për të kontrolluar atë që mund ta quajmë stokun doktoral të institucioneve publike të arsimit të lartë të vitit 2014, cilësinë e realizimit të këtyre

studimeve dhe mungesë të plotë të instrumenteve monitorues në këtë drejtim, *trajtuar më hollësisht në faqet 138 - 152 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Të iniciohet një inspektim i plotë për standardet dhe kushtet e akreditimit të ciklit të tretë të studimeve për të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë, duke synuar vlerësimin e studimeve të ofruara (modulet, profesorët e përfshirë dhe tekstet e studimit), raportet studentë/staf i brendshëm akademik, vlerësimin e gradave që janë fituar gjatë vitit 2012 e në vijim, nëpërmjet kontrollit të cilësisë së kërkimit dhe plotësimi i kërkesave për mbrojtjen e gradës shkencore.

Të rishikohen kushtet dhe afatet (mbase duhet kufij të poshtëm të moshës) e fitimit të titujve të tjerë akademikë kjo në funksion të garantimit të cilësisë së stafëve dhe punës akademike por dhe në funksion të uljes së inflacionin në këtë proces të rëndësishëm me efekte financiare për buxhetin e shtetit (çdo titull ka efekt në fondin e pagave që mbulohet nga buxheti i shtetit), efekt i cili duhet të ishte vlerësuar nga MAS. Inkurajojmë, çdo ndërhyrje që rrit përgjegjësinë institucionale para ligjit për çdo devijim që ka pasoja të shumëfishta për tani dhe brezat që vijnë.

### **Brenda muajit Gusht 2015**

**2.** Nga auditimi i realizuar mbi problematikën e ngritur nga profesorati i Universitetit të Tiranës dhe e debatuar mediatikisht për miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve doktorale (cikli i tretë i studimeve) vetëm në një nga Institucionet e Arsimit të lartë në Shqipëri, konstatoam se Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka miratuar asnjë kuotë për studime doktorature në IAL publike nga viti 2012 e në vijim, duke favorizuar në këtë mënyrë regjistrimin në këtë cikël studimesh vetëm në një Institucion privat të Arsimit të Lartë. Bllokimi dhe mos miratimi i kuotave për studime doktorale për tri vjet me radhë, ka akumuluar artificialisht në rritje kërkesën për këtë lloj të mire publike, që i është drejtuar sektorit privat dhe që është pasuar edhe me drejtim të fluksit të të ardhurave drejt tyre duke shkaktuar të ardhura të munguara për IAL-të publike në shuma të konsiderueshme dhe me efekte në nivelet e investimeve dhe mbulimit të kostove të këtyre institucioneve. Kështu nga një llogaritje e thjeshtë (nisur nga një tarifë minimale prej 204,000 lekë, me një numër minimal kuotash 300), buxhetit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë i mungojnë 61,200 mijë lekë, fonde të cilat, si rrjedhojë e bllokimit të fondeve publike, kanë kaluar në financimin e institucioneve private.

***Për këtë është rekomanduar:***

Ministria të përcaktojë dhe publikojë kalendarin e akreditimit dhe rankimit të IAL-ve dhe programeve të tyre në të gjitha ciklet, të bashkëpunojë me strukturat drejtuese në IAL-të publike për zhblokimin e situatës në ciklin e tretë të studimeve dhe të nxjerrë të gjithat aktet nënligjore e rregullative të nevojshme për të liberalizuar filtrin hyrës dhe forcuar filtrin dalës të doktorantëve potencialë. Ministria të marrë të gjitha masat, që në asnjë rast të mos ketë bllokim të përgjithshëm të kuotave të pranimit për programet e doktoraturës në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë dhe orientim të kuotave për Institucionet private të Arsimit të Lartë.

### **Menjëherë**

**3.** Nga auditimi rastësor dhe me zgjedhje për plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të nëpunësve civilë të institucionit në Sektorin e Burimeve Njerëzore, u konstatua se ato nuk plotësonin

kërkesat e VKM nr.117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. U konstatuan mangësi: CV personale, Shkresa e emërimit në detyrë, Shkresa e emërimit në detyrë si nëpunës civil në periudhë prove, Dëshmi e gjendjes gjyqësore, Certifikatë nga prokuroria ose vërtetim nga prokuroria, Fletë inventari i dosjes së nëpunësit, Formulari për vlerësimin Vjetor, Librezë Pune ose fotokopje e librezës së punës, Letër Reference, raporti Mjeko-Ligjor. Në shumë raste dokumentet që ndodheshin nëpër dosje ishin fotokopje të pa noterizuara, si dhe dokumentet e dosjes së punonjësve nuk janë hedhur në sistemin e DAP-it, *trajtuar më hollësisht në faqet 62-71 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Ministria e Arsimit dhe Sportit, Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e dosjeve të punonjësve me të gjithë dokumentacionin e duhur, duke plotësuar kërkesat VKM nr. 117, datë 5.3.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Ky sektor të marrë masa për hedhjen e të gjitha dosjeve të punonjësve në mënyrë elektronike në bazën e të dhënave të Departamentit të Administratës Publike, në mënyrë që të krijohen kushtet për auditim si dhe të përcaktohen saktë nevojat për trajnim të personelit.

**Menjëherë**

**4.** Nga auditimi i gjithë korrespondencës së realizuar midis Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomisë, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, **Ministrisë së Arsimit dhe Sportit**, për likuidimin e blerjeve apo ndërtimeve në zërin e investimeve **me Letër Kreditit (LC)**, rezultoi se:

Për vitin 2014 është përdorur **në dy raste** pagesa me Letër Kredi, gjithsej **në shumën 595,128,320 lekë**, duke ngurtësuar fondet në një nga bankat e nivelit të dytë, të gjitha për likuidimin e **Shpenzimeve për Investime** (artikulli 231), konkretisht:

“Ndërtimi e objektit Tirana Olimpik Park”, në shumën **200,000,000 lekë**, ose mbi 33 % të vlerë së kontratës dhe “Blerje pajisje dhe tableta për integrimin e platformës e-Learning për shkollat e mesme të përgjithshme”, në shumën **395,128,320 lekë**, ose 100% e kontratës së lidhur.

Konstatuam se, procedura e përdorimit të Letër Kreditit (LC) është kryer me miratim në kohë të Ministrisë së Financave, por është përdorur kjo formë në kundërshtim me udhëzimin e përhershëm të Ministrisë së Financës nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” theksohej se: “Kjo formë likuidimi (ngurtësimi), **përdorej për likuidime të veçanta të shërbimit dhe investimit...deri 10%**”.

Konstatuam se, kontrata ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, dhe Operatorit Ekonomik fitues “E...” shpk, për objektin “Ndërtimi e objektit Tirana Olimpik Park”, është lidhur më datë 23.12.2014, ndërkohë që miratimi i pagesës me L/C është bërë me shkresën nr. 1741/3, datë 31.12.2014 të Ministrisë së Financave, **pra është lidhur kontrata para miratimit të saj nga Ministri i Financave**, *trajtuar më hollësisht në faqet 23 – 27 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Të eliminohen praktika të tilla në realizimin e shpenzimeve buxhetore, sidomos në fund të vitit. Në raste të veçanta (të përcaktuara qartësisht me akte normative), të ketë formate ku specifikohen qartë kushtet e përdorimit të LC, në veçanti për masën e komisioneve dhe mënyrën e pagesës së tyre, pasi të sigurohet dakordësia me Ministrinë e Financave. Rekomandojmë me forcë që në këtë proces të përcaktimit të marrëveshjeve dhe kushteve të

tyre, të sigurohet që strukturat drejtuese të MAS, të bashkëpunojnë me Ministrinë e Financave dhe domosdoshmërisht me Bankën e Shqipërisë.

Të nxirret përgjegjësia institucionale për raportimin e buxhetit në kundërshtim me rregullat dhe parimet bazë buxhetore, lidhur me deklarinimin e investimeve/shpenzimeve të pa kryera si të realizuara.

## Menjëherë

5. Nga auditimi i zbatimit të buxhetit rezultoi se:

i. Nga auditimi konstatohet se, me VKM nr. 411, datë 20.06.2014 “Për bashkëfinancimin e projektit të Stadiumit “Ruzhdi Bizhuta”, Elbasan dhe financimit të Parkut Olimpik të Tiranës”, i ndryshuar me VKM nr. 620, datë 24.09.2014, janë dhënë fonde për rikonstruksionin e Stadiumit në shumën 444 milion lekë, të cilat janë përballuar nga Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe Fondi i Kontigjencës. Këto fonde janë dhënë si bashkëfinancim me Federatën Shqiptare të Futbollit, janë çelur në programin për sportin, konkretisht në artikullin 604 dhe janë transferuar në formë grandi, në llogarinë bankare, në një bankë të nivelit të dytë, me përfitues Federatën Shqiptare të Futbollit.

-Mbështetur në VKM nr. 159, datë 09.05.2014 “Për miratimin e metodologjisë për raportimin, monitorimin dhe vlerësimin e investimeve publike”, miratimi nga Këshilli i Ministrave duhej të kishte paraprakisht mendimin (opinionin) e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. U konstatua se ky mendim ka ardhur më shkresën nr. 1893, datë 09.03.2015, pra 9 muaj pas daljes së vendimit dhe mbi tre muaj pas lidhjes së kontratës. Gjithashtu, theksojmë se kjo ministri është shprehur sipas Vendim të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, që i konsideron fondet e dhëna për Stadiumin si ndihmë shtetërore sipas legjislacionit përkatës për ndihmën, gjë që nuk e gjejmë në ligjin për ndihmat. Në këtë vendimmarrje është trajtuar si ndihmë edhe financimi i pjesshëm për rikonstruksionin e Parkut Olimpik, ndërkohë që VKM ka përcaktuar kalimin e fondeve në llogarinë ekonomike 231, çka tregon për inkoherencë në këto veprime.

ii. Me Aktin Normativ nr. 2, datë 29.12.2014 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 185/2013, datë 28.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar” Ministrisë së Arsimit dhe Sportit i janë bërë ndryshime në planin e buxhetit për shpenzimet kapitale.

Me shkresën nr. 18431/63, datë 30.01.2015 të Ministrisë së Financës, Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit dhe me protokoll hyrës në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nr. 23277, datë 16.02.2015 (me një muaj e gjysmë më vonë se ndryshimi i ligjit), përcaktohet se: “... ndryshimet në planin e buxhetit për shpenzimet kapitale, për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, për vitin 2014, për mungesë fondesh, bazuar në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë, zbatohet pjesërisht...”, pasi nga dalja me vonesë e Aktit Normativ dhe shkresave që e shoqërojnë atë, ndërkohë që veprimet janë kaluar në sistemin e pagesave, në dy programe janë kryer shpenzime mbi planin gjithsej në shumën 19,931 mijë lekë, e konkretisht në programin “Arsimi Universitar”, në shumën 17,931 mijë lekë dhe në programin “Për Sportin” në shumën 2,000 mijë lekë, duke mos vepruar në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 “E drejta për të kryer shpenzime” dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde për zbatimin e buxhetit”, paragrafi 59.

Me shkresën nr. 341/3, datë 23.01.2015 të MZHETS “Për miratimin e detajimit të investimeve sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 29.12.2014”, jepet miratimi se detajimi i planit është bërë në respektim të tavanit të vendosur, referuar dhe shkresës së MAS nr. 9930/3, datë 23.01.2015.

*iii.* Gjithashtu, nga auditimi konstatohet edhe se, me Aktin Normativ, kësaj ministrie i janë shtuar fonde në programin “Arsimi parauniversitar” si Fond për Zhvillimin e Rajoneve, në shumën **108,378 mijë lekë**, ndërkohë që nuk ka patur një vendimmarrje të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, e për *pasojë kjo shtesë nuk është bërë efektive, ose nuk është rialokuar* nëpërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Financës për projektet përfituese të Njësive të Qeverisjes Vendore, *trajtuar më hollësisht në faqet 22-27 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të analizohet problematika e konstatuar lidhur me ndryshimet gjatë vitit në zërat buxhetorë dhe mos veprimin konform kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 40, “E drejta për të kryer shpenzime”, i cili përcakton: “*Fondet e miratuara për njësitë e qeverisjes qendrore në ligjin e buxhetit vjetor përbëjnë kufirin maksimal të shpenzimeve, brenda të cilit Këshilli i Ministrave është i autorizuar të marrë përsipër angazhime dhe të kryejë shpenzime. Këshilli i Ministrave e ushtron këtë autoritet i përfaqësuar nga Ministri i Financave*”. Të nxirret përgjegjësia institucionale dhe të merren masa që për kërkesat dhe ndryshimet e mundshme në zërat buxhetorë, të bashkëpunohet në kohë me Ministrinë e Financës dhe me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

**Në vijimësi**

**6.** Nga auditimi rezultoi se, në pasqyrat financiare të vitit 2013 nuk janë paraqitur të gjitha detyrimet e krijuara, referuar faturave të lëshuara deri më datë 31.12.2013, duke mos zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 29, datë 24.12.2013 “Për procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2013”, Kreu V “Rakordimi përfundimtar i llogarive të kreditorëve dhe debitorëve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe evidentimi i pagesave të vonuara”, pika 26, dhe se nuk janë zbatuar kërkesat e VKM nr. 50, datë 05.2.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, ku në *Shtojcën 1* “Plan veprimi për zbatimin e strategjisë, pasi përse i përket afatit të hartimit të listave përfundimtare të borxhit nuk ka një datë konkrete dhe shumë totale të konfirmuar nga të dy palët për detyrimet e prapambetura, trajtuar më hollësisht në faqet 50-62 të Raportit të Auditimit.

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të merren masa që në të ardhmen të pasqyrohen në evidencën kontabile të gjitha detyrimet, sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

**Në vijimësi**

**7.** Nga auditimi i detyrimeve të prapambetura konstatohet se, Ministria e Arsimit dhe Sportit nuk ka një database, ku të pasqyrohen detyrimet për vendimet gjyqësore sipas radhës së paraqitjes së tyre, si dhe bëhen publike lista e detyrimeve nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, veprim në kundërshtim me pikën 4 e 5 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, *trajtuar më hollësisht në faqet 50-62 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të merren masa që të hartohet e përditësohet database, për të gjitha detyrimet, si dhe të bëhet publike lista e detyrimeve nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësive shpenzuese, apo në ndonjë formë tjetër të publikimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.** Nga auditimi i veprimeve të çeljes së fondeve dhe likuidimit të detyrimeve konstatojmë se, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, nga Drejtoria e Financës, nuk disponohet dokumentacion, si kontratë, faturë, akt marrje në dorëzim, etj., si dokumente vërtetuese të kryerjes së shpenzimit, *por këto dokumente janë në secilën nga njësitë e varësisë së MAS dhe Njësitë e Qeverisjes vendore*, pra në këtë drejtim nuk ka gjetur zbatim pika e 15 e “Strategjia për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe plani i veprimit”, veprim që bie ndesh dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pika 21 ku thuhet: “Nëpunësit Autorizues të njësive qendrore e vendore sigurohen që të gjitha urdhrat e pagesës të paraqitura në degën e thesarit respektiv, të jenë të shoqëruar me dokumentacionin e plotë justifikues”, *trajtuar më hollësisht në faqe 56-62 të Raportit të Auditimit*

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të merren masa që të plotësohet dokumentacioni i duhur për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, konform kërkesave të pikës 15 të “Strategjia për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe plani i veprimit” dhe pikën 21 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” si dhe kërkesave të Udhëzimit të Ministrit të Financës nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kapitulli III, nënpika “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve”

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**9.** Nga auditimi u konstatua se kompania “A...” sh.a, për realizimin e kontratës “Lidhja dhe furnizimi me internet i 2000 shkollave në arsimin para universitar”, ka faturuar shërbim të pakonfirmuar, ***në shumën 32.504.427,74 lekë***, kjo referuar Raportit të Pranimi të mallit/shërbimit të hartuar nga Grupi i Menaxhimit të Kontratës, në bazë të Manualit Operacional të Projektit CBA. Vlera e mësipërme nuk është paguar, për faktin se shërbimi nuk verifikohet të jetë kryer dhe me të drejtë nuk është konfirmuar nga Blerësi/Shkolla/DAR/ZA dhe Grupi i Menaxhimit të Kontratës, sikurse përcaktohet në kontratë. Gjithashtu konstatohet se, nga kompania faturat e shërbimit janë lëshuar në mënyrë përmbledhëse, të pa specifikuara për secilën njësi, ashtu sikurse kërkohet në kushtet e kontratës dhe në disa raste e panënshkruar nga të dy palët. Aktet përfundimtare të rakordimit për ofrimin e shërbimit të internetit *sipas njësive*, ndërmjet drejtuesve të DAR/ZA dhe përfaqësuesve të kompanisë “A.....” sh.a, janë mbajtur në periudhën mars-korrik 2014 për një periudhë shërbimi 12 mujore (mars 2012 deri shkurt 2013), *pra mbi një vit nga përfundimi i shërbimit, por nuk është mbajtur akti i rakordimit përfundimtar ndërmjet palëve nënshkruese të kontratës*. Vërehet se për 8 DAR/ZA këto akte nuk janë nënshkruar nga përfaqësuesit e kompanisë, konkretisht: për DAR Gjirokastrë, Korçë, Berat, Fier, Pukë, si dhe ZA Gramsh, Skrapar dhe Mallakastër, *trajtuar më hollësisht në faqe 56-62 të Raportit të Auditimit*.

***Për këtë është rekomanduar:***

Ministria e Arsimit dhe Sportit, të kryejë rakordimet përfundimtare me kompaninë “A...” sh.a, si dhe ti kërkojë kompanisë të bëjë anulimin e të gjithë faturave, të cilat i

korrespondojnë vlerës **prej 32.504.427 lekë**, vlerë e cila nuk është pranuar nga MAS, referuar termit të kontratës se: *“Dokumentacioni/fatura e paraqitur për pagesë është konform legjislacionit në fuqi, si dhe e nënshkruar nga të dy palët, Blerësi dhe Shitësi”*.

**Menjëherë**

**10.** Nga auditimi konstatohet se, aktiviteti i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 16.09.2013 e në vazhdim është bazuar në kuadrin metodik dhe metodologjik në fuqi, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm”, miratuar me urdhrin nr. 69, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave. Pas korrikut 2012, aktiviteti i kësaj Drejtorie është bazuar në “Manualin Specifik të Auditimit të Brendshëm për MASH”, miratuar nga Ministri me shkresën nr. 2494, datë 18.7.2012. Konstatohet edhe se, për periudhën objekt auditimi, DAB asnjëherë nuk ka kryer auditime të plota për aparatën e Ministrisë ose angazhim performance për funksionimin e drejtorive të ndryshme të saj, arsyetuar kjo me faktin se ky institucion është audituar në vijimësi nga ana e KLSH, *trajtuar më hollësisht në faqet 100-107 të Raportit të Auditimit*.

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të merren masa që të plotësohet plani i auditimeve vjetore, me auditimin e plotë të aktivitetit të aparatit të Ministrisë, si dhe auditime performance për funksione të rëndësishme që rezultuan me probleme nga ky auditim por edhe bazuar në ndjeshmëritë që vijnë nga publiku dhe shoqëria civile.

**Brenda muajit Korrik 2015**

**11.** Nga auditimi u konstatua se, dosjet e auditimit për vitin 2013 dhe 2014 janë të plotësuara me aktet shkresore të nevojshme, por nuk janë arkivuar ende, duke mos përmbushur kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, udhëzuesit “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë” dhe manualit të auditimit, miratuar nga urdhrin nr. 69, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave, *trajtuar më hollësisht në faqet 100-107 të Raportit të Auditimit*.

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të merren masa që të dorëzohen në arkivën e institucionit dosjet e auditimit të brendshëm për vitin 2013-2014, pasi të jetë inventarizuar çdo informacion përbërës, sipas kërkesave të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor.

**Menjëherë**

**12.** Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në MAS ka ushtruar auditim në DAR Fier dhe ZA Lushnje lidhur me emërimin e drejtuesit në këtë ZA, ku megjithë shkeljet e bëra nga ana e përgjegjëses së Zyrës Arsimore Lushnjë znj. L. T, në memorandum apo Raportin Final të Auditimit nuk ka evidentuar asnjë përgjegjësi, përsa i përket emërimit të saj. Për gjetjen e konstatuar nga auditi në lidhje me dokumentacionin personal para emërimit, duhej të bëhej rekomandim edhe për përgjegjësinë e Drejtorit të DAR Qarku Fier z. Sh. A për emërimin e znj. L. T, në kundërshtim me Urdhrin e MAS nr. 57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar", pika B.1 sipas të cilës “Kandidati për drejtor i Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar duhet të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar” dhe pika C



“Zëvendësimi i përkohshëm i drejtorit”, *trajtuar më hollësisht në faqet 100-107 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit të merren masa që emërimet e personelit drejtues të DAR/ZA të bëhet sipas Urdhrit të MAS nr. 57, datë 12.11.2013 "Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar", duke monitoruar/kontrolluar këto emërimet dhe nxjerrë përgjegjësitë në rastet e shkeljeve ligjore, për të ndaluar frymën e mosndëshkueshmërisë dhe rritjes së papërgjegjshmërisë institucionale të personelit.

**Menjëherë**

**13.** Nga auditimi është konstatuar se, për periudhën objekt auditimi, numri i punonjësve në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm është 4 punonjës, jo vetëm në kundërshtim me strukturën e miratuar nga Këshilli i Ministrave, por dhe duke paraqitur një risk të lartë në realizimin e planit të auditimeve, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 100-107 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të analizohen me përgjegjësi nevojat për burime njerëzore të kësaj njësie me rëndësi dhe të merren masa jo vetëm për plotësimin me burimet e nevojshme por dhe me kapacitete të larta profesionale, duke synuar përmirësimin e punës së kësaj njësie dhe vënien e saj në funksion të plotë në ndihmë të menaxhimit të këtij institucioni.

**Menjëherë**

**14.** Nga auditimi rezultoi se, nga 28 rekomandime gjithsej të lëna, janë zbatuar 22 prej tyre dhe janë në proces zbatimi 6 rekomandime, pra niveli i zbatimit të rekomandimeve të lëna është në masën 79 % e tyre, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 11-13 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të merren masa për ndjekjen dhe realizimin e detyrave, si më poshtë:

**i.** Miratimin e Projektvendimit të hartuar në vitin 2015 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë jashtë vendbanimit dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, ku në pikën 1 të projektvendimit i kërkohet njësitëve arsimorë vendorë që të unifikohen praktikat e veprimit të njësitëve të varësisë lidhur me distancat dhe çmimet e shërbimit të transportit të nxënësve dhe mësuesve dhe në pikën 2 të projektvendimit i kërkohet njësitëve arsimorë vendorë që mbështetur në numrin e mësuesve dhe nxënësve që planifikohen të përfitojnë nga shërbimi i transportit, në bashkëpunim me këshillat e qarqeve, njësitë bazë të qeverisjes vendorë dhe shoqatën e transportit publik, të miratojnë hartën e linjave sipas largësive

**ii.** Rregullimet kontabël në përputhje me standardet e kontabilitetit publik si në MASH dhe në institucionet e varëse të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës që në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi të kryejnë evidentimin saktë të detyrimeve debitore me shpresë arkëtimi dhe të ndiqen në rrugë gjyqësore, të gjitha detyrimet sipas të dhënave të pasqyrave financiare.

**iii.** Rregjistrimin e të gjithë aktiveve të qëndrueshme të këtyre institucioneve, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

*iii.* Përmbylljen e procesit për Strategjinë e Riskut dhe hartimin e regjistrit përfundimtar të tij, në përputhje me nenin 21, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

#### **Brenda muajit Shtator 2015**

**15.** Nga auditimi u konstatua se, nga institucioni nuk janë kryer trajnime të stafit në drejtim të drejtim njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit të punës dhe menaxhimin e fondeve publike së njësisë menaxhuese, *trajtuar më hollësisht në faqet nr.107-116 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, të merren masa në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kryerjen e trajnimeve dhe seminareve, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike apo dhe nga Ministria e Financave, për mënyrën e analizës së Menaxhimit të Riskut, si dhe të gjitha detyrimeve të tjera, të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë së Financës për menaxhimin e buxhetit dhe aktiveve të Ministrisë, duke siguruar një pjesëmarrje në këto trajnime të drejtuesve të programeve buxhetore, drejtuesve të njësive shpenzuese, nëpunësve autorizues, nëpunësve zbatues, si dhe specialistë të tjerë.

**Në vijimësi**

**16.** Nga verifikimi i projektit dhe preventivit të objekteve të prokuruar, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e preventivit, janë me zëra pune që nuk janë në manualet e preventivimit. Këto zëra pune janë shoqëruar me analiza çmimi, por pa argumentim me dokumente për çmimet e nënzërit “material” të kostos. Gjithashtu në disa zëra pune, ka mospërputhje të volumeve apo çmimeve sipas manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit, duke rritur në mënyrë fiktive vlerën e fondit limit, në kundërshtim me VKM nr, 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 72 - 80 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Të merren masa nga strukturat e caktuara nga Titullari i MAS, për verifikimin e projekteve dhe preventivave të objekteve që prokurohen, në mënyrë që fondi limit të përcaktohet nga çmimet e manualeve korrente ose me analiza çmimesh të përditësuar.

**Në vijimësi**

**17.** Në auditimin e disa procedurave prokurimi është konstatuar se disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit janë diskriminuese në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 dhe që nuk përputhen me natyrën e punimeve dhe volumet e preventivit *trajtuar më hollësisht në faqet nr. 72 - 97 dhe 123-138 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Strukturat e caktuara për vendosjen e kriterëve të kualifikimit, të marrin masa që të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre dhe të përputhen në natyrë dhe sasi me preventivat e objekteve që prokurohen.

**Në vijimësi**

**18.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Hiqmet Buzi, Fshati Kallm i Madh”, bazuar edhe në dokumentet shtesë që shoqëruan observacionin, u konstatua se nuk ishin bërë rakordimet në situacionin përfundimtar të volumeve të punimeve të kryera, si dhe pagesa e këtij situacioni, *trajtuar më hollësisht në faqet 133-135 të Raportit të Auditimit.*

***Për këtë është rekomanduar:***

Strukturat e njësisë vendore, Komuna Mbrostar, të bëjë ndjekjen e përfundimit të punimeve sipas kontratës së punimeve dhe specifikimeve teknike që shoqërojnë këtë kontratë dhe rakordimet e volumeve të punës para pagesës së situacionit përfundimtar. Gjithashtu, duke qenë se objekti është brenda periudhës njëvjeçare të garancisë së defekteve, problemet e cilësisë në këtë objekt, të zgjidhen brenda kësaj periudhe.

**Menjëherë**

### **C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjecare të Fshatit Thanasaj”, u konstatua diferencë në volumet e punimeve të kryera në fakt, krahasuar me preventivin e objektit, si pasojë e të cilave është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve vlera prej 584,868 lekë.

***Per sa më sipër rekomandoj:***

Nga Komuna Dushk të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **584,868 lekë**, të përfituara padrejtësisht nga bashkimi operatorëve ekonomik “Xh... & K...” sh.p.k dhe “G.... C.” sh.p.k, në zbatimin e punimeve në objektin “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare të Fshatit Thanasaj”.

**Menjëherë**

**2.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve në objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Hiqmet Buzi, Fshati Kallm i Madh”, u konstatua diferencë në volumet e punimeve të kryera në fakt, krahasuar me preventivin e objektit, si pasojë e të cilave është përfituar më tepër nga sipërmarrësi i punimeve vlera prej **196,800 lekë**.

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Komuna Mbrostar të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, me qëllim shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **196,800 lekë**, të përfituara padrejtësisht nga operatori ekonomik “B.... B” sh.p.k, në zbatimin e punimeve në objektin “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Hiqmet Buzi, Fshati Kallm i Madh”.

**Menjëherë**

**3.** Nisur nga konstatimi për përdorimin joefektiv të fondeve, të cilat rezultuan me dëm në Buxhetin e Shtetit, në procedurat e prokurimit si më poshtë:

**3/1.** Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”, kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomikë. Janë skualifikuar 7 operatorë ekonomikë dhe është kualifikuar OE “E...” shpk, që siç shihet më lart, ka ofertuar në vlerën ekonomike më të lartë. Nga verifikimi i dokumentacionit për operatorin fitues “E...” shpk konstatohet si më poshtë:

- Vërtetimet e Degës Rajonale të Sigurimeve Shoqërore për numrin e punonjësve për vitin 2011 dhe 2012 janë me datë 19.05.2014, ose më shumë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertave, e përcaktuar në Kushtet e Përgjithshme të Kualifikimit (KPK).

- Nuk rezulton të ketë në pronësi apo me qira kamionë me kapacitet mbajtës 20 ton.

- Nga verifikimi i aktkolaudimit të punimeve të objektit të paraqitur si eksperiencë e ngjashme, vlera e objektit sipas preventivit është 291,036,200 lekë, ndërsa vlera faktike e punimeve të kryera është 820,393,229 lekë. Në këtë objekt, OE "E...." shpk ka qenë investitor dhe zbatues i punimeve. Ky fakt nuk është trajtuar nga KVO dhe nuk administrohet asnjë dokument, ku të kërkohet sqarim nga OE "E...." shpk, pasi vlera e preventivit prej 291,036,200 lekë nuk e plotëson kushtin e vënë për eksperiencën e ngjashme.

- Në listë pagesat e paraqitura nga OE, drejtuesja teknike A. B figuron e siguruar vetëm për muajt Gusht-Shtator 2014, në një kohë që është drejtuese teknike e shoqërisë të paktën prej datës së regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin themeltar 05.05.2014 (sipas licencës së shoqërisë NZ. 4612/3). Mostrajtimi nga KVO e këtij fakti, është në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik", me ndryshimet, neni 45, "Kriteret e përjashtimit të kandidatëve ose ofertuesve" pika 2/d.

Nga verifikimi i dokumentacionit për OE "G.... 2" shpk konstatohet si më poshtë:

- Dokumentet, që sipas argumentimit të KVO-së, mungojnë dhe për pasojë OE nuk e plotëson pikën 1 të KPK, janë Ekstrakti Historik dhe i Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit që lëshohet nga QKR dhe Shtojca "Deklaratë mbi gjendjen gjyqësore", të cilat administrohen në sistemin elektronik dhe mbajnë respektivisht datat 07.10.2014 dhe 20.10.2014.

- Objekti i paraqitur si eksperiencë e ngjashme, plotëson kushtin e kërkuar në KVK.

- OE ka paraqitur të gjitha autorizimet e prodhuesve, të materialeve të kërkuara në KVK, por jo me të njëjtin emërtim si ato të kërkuara në KVK.

Nga verifikimi i dokumentacionit për BOE "N...."shpk & "A. K" shpk & "A" shpk konstatohet si më poshtë:

- Objekti i paraqitur si eksperiencë e ngjashme, plotëson kushtin e kërkuar në KVK.

- OE ka paraqitur skedat teknike për të gjithë materialet e kërkuara në KVK, por mungojnë katër autorizime nga prodhuesi.

**Nga sa sipër, të gjithë operatorët pjesëmarrës kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur.**

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, mangësitë e OE fitues "E..." shpk nuk janë trajtuar, pasi nuk është lenë gjurmë në Raportin Përmbledhës. Për të patur standard të njëjtë në vlerësimin e ofertave, me logjikën dhe kriterin që ka përdorur KVO në lejimin e konkurrimit të operatorit fitues, sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik", duhet të ishin trajtuar si devijime të vogla edhe mangësitë e trajtuara për OE "G.... 2" me ofertë 448,907,554 lekë dhe BOE "N...."shpk & "A. K" shpk & "A..." shpk me ofertë 421,966,785 lekë. Nga skualifikimi i këtyre konkurruesve **i është shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm në vlerën prej 78,745,737 lekë**

**3/2.** Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar" me fond limit 168,530,004 lekë kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomikë. KVO, pas shqyrtimit të ofertave ka kualifikuar BOE "E.../K"shpk & "I... S..." shpk, OE "E..." shpk dhe OE "B..." shpk dhe ka skualifikuar operatorët e tjerë:

- Me Formularin e Ankesës datë 13.08.2014, BOE "T.. I..."shpk & "C...." ltd, ka paraqitur ankesë pranë AK, në të cilin ka kundërshtuar skualifikimin nga gara për arsyet e cituara nga KVO, duke paraqitur dokumentacionin, për mungesën e të cilit është skualifikuar.

Pas shqyrtimit në tërësi të procedurës së prokurimit nga zyrtarja e autorizuar, me shkresën e datës 15.08.2014 është rekomanduar që të kualifikohen OE “M.L...” shpk, BOE “E/K”shpk & “I... S...” shpk, OE “E...” shpk dhe OE “B...” shpk dhe të

- Pas rekomandimit të mësipërm me Vendimin nr. 6061 prot, datë 15.08.2014 Ministrja e MAS, ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së BOE “T.. I...”shpk & “C...” ltd dhe rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke vijuar me përzgjedhjen e ofertës fituese (OE “M. L....” shpk).

- Me Formularin e Ankesës datë 21.08.2014, BOE “T... I...”shpk & “C....” ltd, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), në të cilin ka kundërshtuar skualifikimin nga gara për arsyet e cituara në vendimin e titullarit të AK.

- KPP, pas shqyrtimit të ankesës së BOE “T... I...”shpk & “C...” ltd, dokumentacionit bashkëlidhur si dhe dokumenteve të dërguara nga AK, me Vendimin Nr. 519/2014, datë 12.09.2014 ka pranuar ankesën e paraqitur nga ky operator ekonomik dhe ka vendosur që AK të kualifikojë ofertën e BOE “T... I...”shpk & “C....” ltd.

-Me shkresën Nr. 6719/1, datë 19.09.2014, Ministri i MAS i është drejtuar kryetarit të KPP z. D. B me kërkesën për rishqyrtim të vendimit nr. 519/2014, datë 12.09.2014.

- KPP, pas shqyrtimit të ankesës së AK, me Vendimin Nr. 519/3/2014, datë 06.10.2014 ka arsyetuar se *“Si përfundim, KPP gjykon se argumentet dhe kërkesa e paraqitur nga AK nuk qëndrojnë, për rrjedhojë ky i fundit duhet të zbatohet vendimin e KPP-së nr. 519/2014, datë 12.09.2014, duke kryer kualifikimin e BOE “T.. li...”shpk & “C....” ltd dhe më pas të vazhdojë me hapat e tjerë proceduralë”* dhe *“KPP merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare (neni 19/1 i LPP)”*. Pas këtij arsyetimi ka vendosur *“Mospranimin e kërkesës së MAS për rishikimin e vendimit 519/2014”*.

Me shkresën nr. 7318/1 prot, datë 09.10.2014, Ministrja e AS ka informuar KPP për zbatimin e vendimit 519/2014.

- KPP, pasi ka shqyrtuar shkresën nr. 7318/1 prot, datë 09.10.2014, ka vendosur të lejojë AK të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pra për lidhjen e kontratës me BOE “T... li...”shpk & “C....” ltd.

Me vendimin nr. 3891/3, datë 09.10.2014 Ministri i AS, ka bërë përsëri pezullimin e procedurës së prokurimit dhe emërimin e zyrtarit të autorizuar z. E. T, për shqyrtimin e ankesës së BOE “E.../K shpk & I.-S...” shpk të datës 08.10.2014.

Me shkresën pa numër, datë 13.10.2014 zyrtari i autorizuar z. E. T, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, ka shqyrtuar ankesën dhe ka rekomanduar pranimin e ankesës së BOE “E.../K shpk & I.-S.” dhe skualifikimin e BOE “T. L...”shpk & “C....” ltd.

Ky veprim, pas vendimeve të KPP-së Nr. 519/2014, 519/3/2014 dhe 519/5/2014, bie ndesh me nenin 19/1 të Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006, pika 2 sipas të cilit *“Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”* dhe nenin 64/3 *“Ankimimi në gjykatë”*, pika 1 sipas të cilit *“ Palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën përkatëse”*.

Këtë rekomandim Ministri i MAS e ka marrë në konsideratë dhe me Vendimin nr. 3891/4 prot, datë 13.10.2014, ka vendosur të kërkojë nga KVO rivlerësimin e procedurës.

Në datën 22.10.2014, KVO ka paraqitur Raportin Përmbledhës të kësaj procedure, i cili është miratuar nga titullarja e MAS. Në këtë Raport është propozuar shpallja fitues e “E...” shpk.

Me shkresën nr.3891/6, datë 29.10.2014 është lidhur Kontrata e Furnizimit me kontraktor BOE “E.../K shpk & I...-S....” me vlerë totale të objektit 138,914,250 lekë pa tvsh, ose 166,697,100 lekë me tvsh.

Si përfundim, nga mungesa e vlerësimit të procedurës sipas vendimit nr. 519/2014 të KPP, skualifikimi i BOE “T.. 1..”shpk & “C....” ltd, me vlerë të ofertës ekonomike 109,638,860 lekë pa tvsh **buxhetit të shtetit i është shkaktuar një dëm në vlerën 29,275,390 lekë.**

***Për këtë është rekomanduar:***

Nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit të shikohet mundësia e rikuperimin të shumës së konstatuar si dëm ekonomik, për dy procedurat e sipërpërmendura nëpërmjet ndjekjes dhe rinegociimit të çmimeve të ofertuar nga shoqëritë fituese të procedurave tenderuese të shpjeguara më sipër.

**Menjëherë**

#### **D. MASA ADMINISTRATIVE**

##### **Për Inspektoratin i Mbrojtjes së Territorit Vendor , Dega Fier**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve të ndërtimit, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, neni 15, për shkelje të nenit 7, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve”, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,

Mbështetur në Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, neni 15, për shkelje të nenit 7, ***i kemi rekomanduar*** Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Dega Fier, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, ***të vendosë gjobë*** për:

1. Znj. N. M, me cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Rikonstruksion i Shkollës 9-vjeçare të Fshatit Thanasaj” dhe “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Hiqmet Buzi, Fshati Kallm i Madh”, për diferencat në volume të konstatuara në objektet e mësipërme, si pasojë e të cilave është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën totale prej 781,668 lekë.

##### **Për Agjencinë e Prokurimit Publik.**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet dhe aktverifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Mbështetur në nenin 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ***i kemi rekomanduar*** Drejtorit të Agjencisë së Prokurimit Publik, ***të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për personat si më poshtë:***

1. **P. N**, në cilësinë e kryetarit të KVO në tenderin “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”, pasi në këtë procedurë prokurimi ka shpallur fitues duke përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorin ekonomik që ka paraqitur ofertën më të lartë ekonomike nga tetë

operatorë pjesëmarrës. Në këtë procedurë një anëtar i KVO-së, me profesionin inxhinier, ka bërë skualifikimin e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK. Nga përdorimi i standardit të dyfishtë, ka skualifikuar dy operatorë ekonomikë me vlerë më të ulët, kualifikimi i të cilëve do ti kishte kursyer Buxhetit të Shtetit vlerën prej 78,745,737 lekë. Në sistemin elektronik dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, konstatohet se anëtari i KVO-së z. A. P ka skualifikuar të gjithë shoqëritë pjesëmarrëse në tender, për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK.

**2. E. K,** në cilësinë e anëtarit të KVO në tenderin “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”, pasi në këtë procedurë prokurimi ka shpallur fitues duke përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorin ekonomik që ka paraqitur ofertën më të lartë ekonomike nga tetë operatorë pjesëmarrës. Në këtë procedurë një anëtar i KVO-së, me profesionin inxhinier, ka bërë skualifikimin e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK. Nga përdorimi i standardit të dyfishtë, ka skualifikuar dy operatorë ekonomikë me vlerë më të ulët, kualifikimi i të cilëve do ti kishte kursyer Buxhetit të Shtetit vlerën prej 78,745,737 lekë. Në sistemin elektronik dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, konstatohet se anëtari i KVO-së z. A. P ka skualifikuar të gjithë shoqëritë pjesëmarrëse në tender, për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK.

**3. A. K,** në cilësinë e kryetarit të KVO në tenderin “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi ka bërë skualifikimin e OE “M. L..”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

**4. D. S,** në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi ka bërë skualifikimin e OE “M. L..”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

**5. E. B,** në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi ka bërë skualifikimin e OE “M. L...”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

**6. A. T,** në cilësinë e anëtares së grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit të objektit “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”, pasi si anëtare e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit, ka hartuar kërkesa të veçanta për kualifikim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 20, pika 1.

**7. L. S,** në cilësinë e anëtares së grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit të objektit “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”, pasi si anëtare e grupit të punës për përllogaritjen e fondit limit, ka hartuar kërkesa të veçanta për kualifikim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 20, pika 1.

**8. E. T** me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe në cilësinë e zyrtarit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës së BOE “E../K shpk & I.-S...” shpk, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi në kundërshtim me nenin 19/1 të Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006, pika 2 sipas të cilit “Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”, ka rekomanduar pranimin e ankesës së BOE “E../K shpk & I.-S...”, pas vendimeve të KPP-së Nr. 519/2014, 519/3/2014 dhe 519/5/2014, të cilat shpallnin fitues BOE “T.. I.” shpk & “C...” ltd, lidhja e kontratës me të cilin, do të sillte një kursim në Buxhetin e Shtetit në vlerën 29,275,390 lekë.

**9. M. N**, në cilësinë e kryetarit të KVO në tenderin “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare të fshatit Thanasaj”, pasi në procedurën e prokurimit ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “J...” shpk, në mospërputhje me Nenet 1, 2 dhe Neni 20 të ligjit “Për prokurimin publik” Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe VKM Nr. 1, Datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Kreu II.

**10. B. I**, në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare të fshatit Thanasaj”, pasi në procedurën e prokurimit ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “J...”shpk, në mospërputhje me Nenet 1, 2 dhe Neni 20 të ligjit “Për prokurimin publik” Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe VKM Nr. 1, Datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Kreu II.

**11. E. S**, në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare të fshatit Thanasaj”, pasi në procedurën e prokurimit ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “J...”shpk, në mospërputhje me Nenet 1, 2 dhe Neni 20 të ligjit “Për prokurimin publik” Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe VKM Nr. 1, Datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Kreu II.

**12. A. K**, në cilësinë e zyrtarit të autorizuar për shqyrtimin e ankesave në tenderin “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare të fshatit Thanasaj”, pasi gjatë shqyrtimit të ankesës për procedurën e prokurimit ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “J...” shpk, në mospërputhje me Nenet 1, 2 dhe Neni 20 të ligjit “Për prokurimin publik” Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar dhe VKM Nr. 1, Datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, Kreu II.

## **E. MASA DISIPLINORE**

Bazuar në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “ç” dhe në nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 2 të Kreut X “Disiplina në Shërbimin Civil” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, Vendimit të KM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, Kreu II “Procedura disiplinore”, pika 3, si dhe Udhëzimit të Departamentit të Administratës Publike nr. 1, datë 02.04.2014 “Elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, *i kemi rekomanduar* Ministrin të Arsimit dhe Sportit fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore dhe njoftimin e Departamentit të Administratës Publike për:

### **E/1. “Largim nga shërbimi civil”,**

**1. Për z P. N**, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pasi:



Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park” ka ndikuar në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS në vendosjen e kritereve diskriminuese në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2 dhe nenin 20, pika 1, “Mosdiskriminimi”, sipas të cilit “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

Ka shpallur fitues në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar operatorin ekonomik që ka paraqitur ofertën më të lartë ekonomike nga tetë operatorë pjesëmarrës, duke përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave. Nga përdorimi i standardit të dyfishtë, ka skualifikuar dy operatorë ekonomikë me vlerë më të ulët, kualifikimi i të cilëve do ti kishte kursyer Buxhetit të Shtetit vlerën prej 78,745,737 lekë. Gjithashtu, në fazën e projekt raportit ka bërë presion të kundërligjshëm dhe të qëllimshëm ndaj audituesve të KLSH-së pasuar me kërcënimin shkresor për kryerjen e një kallëzimi penal ndaj audituesve me akuzën e falsifikimit të dokumenteve, është mbajtur qëndrim refuzues për dhënien e observacioneve mbi shkeljet e konstatuara, procesverbalet tona i ka konsideruar si akte absolutisht të pavlefshme dhe ka vënë në dyshim kompetencën institucionale të KLSH-së në auditimin e procedurave të prokurimit publik të realizuara nga MAS.

**2. Për z. E. K** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave pasi:

Ka shpallur fitues, duke përdorur standard të dyfishtë në vlerësimin e ofertave, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatorin ekonomik që ka paraqitur ofertën më të lartë ekonomike nga tetë operatorët pjesëmarrës,. Nga përdorimi i standardit të dyfishtë, ka skualifikuar dy operatorë ekonomikë me vlerë më të ulët, kualifikimi i të cilëve do ti kishte kursyer Buxhetit të Shtetit vlerën prej 78,745,737 lekë.

**3. Për z. B. D** me detyrë Drejtor i Agjencisë së Shërbimit të Sporteve pasi ka pranuar projekt preventivin e objektit “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park” me vlerë 605,262,310 lekë nga një shoqëri që nuk rezulton të jetë shoqëri e autorizuar/kontraktuar për rishikimin e projektit dhe e ka paraqitur atë për prokurim në MAS. Ky preventiv, i hartuar “pa kosto financiare”, ka rritur në mënyrë fiktive koston e objektit në vlerën 1,363,100 lekë.

**4. Për z. E. T** me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike dhe në cilësinë e zyrtarit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës së BOE “E.../K shpk & I...-S...” shpk, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi në kundërshtim me nenin 19/1 të Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006, pika 2 sipas të cilit “Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të sqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”, ka rekomanduar pranimin e ankesës së BOE “E.../K shpk & I...-S...”, pas vendimeve të KPP-së Nr. 519/2014, 519/3/2014 dhe 519/5/2014, të cilat shpallnin fitues BOE “T.. I..” shpk & “C...” ltd, lidhja e kontratës me të cilin, do të sillte një kursim në Buxhetin e Shtetit në vlerën 29,275,390 lekë.

**5. Për z. Sh. A**, me detyrë drejtor i DAR Qarku Fier, për emërimin e znj. L.T, pa përvojë në fushën e arsimit, në pozicionin e drejtorit të Zyrës Arsimore Lushnjë, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 57, datë 12.11.2013, pika B.1, sipas të cilës “Kandidati për drejtor i Institucionit Publik të Arsimit Parauniversitar duhet të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”.

**E/2.** Mbështetur në Ligjin Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa c dhe Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin

civil”, neni 58, pika a, b dhe c, *i rekomandoj* Ministrin të Arsimit dhe Sportit, për shkeljet e konstatuara në vlerësimin e procedurave të prokurimit, të japë masa disiplinore **“Vërejtje”** deri në **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë”**, duke gjykuar në bazë të përgjegjësisë rast pas rasti (të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit), për punonjësit si më poshtë:

**1. A. K.**, në cilësinë e kryetarit të KVO në tenderin “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi ka bërë skualifikimin e OE “M. L...”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

**2. D.S.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi ka bërë skualifikimin e OE “M. L...”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

**3. E. B.**, në cilësinë e anëtarit të KVO, në tenderin “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi ka bërë skualifikimin e OE “M. L...”, në kundërshtim me nenin 53, pika 3 të Ligjit nr. nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.

**4. A. T.**, në cilësinë e anëtares së grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit të objektit “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”, pasi si anëtare e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit, ka hartuar kërkesa teknike të veçanta për kualifikim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, pika 1.

**5. L. S.**, në cilësinë e anëtares së grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit të objektit “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”, pasi si anëtare e grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit, ka hartuar kërkesa teknike të veçanta për kualifikim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 20, pika 1.

## **F. KALLZIM PENAL**

**1.** Bazuar në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar neni 281, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, i sugjerojmë trajtimin e detajuar tekniko juridik nga ana e Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, si dhe plotësimin e të kallëzimit penal nr. 1217/6, datë 27.03.2015, të bërë për **Z. P. N** me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, që në fazën e projekt raportit për shkeljet flagrante në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park”. *Kallëzimi është bërë që në fazën e projekt raportit për shkak të presionit të kundërligjshëm dhe qëllimshëm që Sekretari i Përgjithshëm i MAS ka ushtruar ndaj audituesve të KLSH-së si dhe qëndrimin të tij refuzues për dhënien e observacioneve mbi shkeljet e konstatuara, faktit që procesverbaleve tona janë konsideruar si akte absolutisht të pavlefshme, dhe vënies në dyshim të kompetencës institucionale të KLSH në auditimin e*

*procedurave të prokurimit publik të realizuara nga MAS, plotësuar me kërcënimin shkresor për kryerjen e një kallëzimi penal ndaj audituesve me akuzën e falsifikimit të dokumenteve, fakte që mund të kompromentonin kallëzimin në fazën finale të Raportit të Auditimit.*

Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park” konstatuam se z. N.. në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të MAS ka ndikuar në vendosjen e kriterëve diskriminuesë në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2 dhe nenin 20, pika 1, “Mosdiskriminimi”, sipas të cilit “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”. Ka shpallur fitues në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar operatorin ekonomik që ka paraqitur ofertën më të lartë ekonomike nga tetë operatorë pjesëmarrës, duke përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave. Në këtë procedurë një anëtar i KVO-së, me profesionin inxhinier, ka bërë skualifikimin e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK. Nga përdorimi i standardit të dyfishtë, skualifikimi i dy operatorë ekonomikë me vlerë më të ulët, i ka krijuar Buxhetit të Shtetit një dëm në vlerën prej 78,745,737 lekë. Në sistemin elektronik dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, konstatohet se anëtari i KVO-së z. A. P ka skualifikuar të gjithë shoqëritë pjesëmarrëse në tender, për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK.

**2. Për Z. E.K** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Financës i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtimi i objektit Tirana Olimpik Park” ka shpallur fitues në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar operatorin ekonomik që ka paraqitur ofertën më të lartë ekonomike nga tetë operatorë pjesëmarrës, duke përdorur dy standarde në vlerësimin e ofertave. Në këtë procedurë një anëtar i KVO-së, me profesionin inxhinier, ka bërë skualifikimin e të gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në tender për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK. Nga përdorimi i standardit të dyfishtë, skualifikimi i dy operatorë ekonomikë me vlerë më të ulët, i ka krijuar Buxhetit të Shtetit një dëm në vlerën prej 78,745,737 lekë. Në sistemin elektronik dhe në dokumentacionin e administruar në dosje, konstatohet se anëtari i KVO-së z. A.P ka skualifikuar të gjithë shoqëritë pjesëmarrëse në tender, për shkak të mosplotësimit të eksperiencës së ngjashme të kërkuar në KVK.

**3. Z E.T** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, me cilësinë e zyrtarit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës së BOE “E../K shpk & I.-S...” shpk, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje mobilierie për shkollat e sistemit arsimor pasuniversitar”, pasi i ka rekomanduar titullarit të Autoritetit Kontraktor pranimin e ankesës së BOE “E../K shpk & I.I-S..”, pas vendimeve të KPP-së Nr. 519/2014, 519/3/2014 dhe 519/5/2014, të cilat shpallnin fitues BOE “T.. I..”shpk & “C...” ltd, lidhja e kontratës me të cilin, do të sillte një kursim në Buxhetin e Shtetit në vlerën 29,275,390 lekë, e cila përbën **dëm ekonomik**. Kualifikimi i kryer është në kundërshtim me nenin 19/1 të Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006, pika 2 sipas të cilit “Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomikë.

- KVO, pas shqyrtimit të ofertave ka kualifikuar BOE “E../K”shpk & “I.. S...” shpk, OE “E....” shpk dhe OE “B....“ shpk dhe ka skualifikuar operatorët e tjerë:

✓ Refuzimi i ofertës së OE “M.L.” shpk ka ardhur, pasi sipas KVO-së “Mungon inxhinieri i drurit”.

✓ Refuzimi i BOE “T.. I...”shpk & “C...” ltd ka ardhur, pasi sipas KVO-së “Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës”, “Nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve sipas kriterit të përcaktuar nga DST” dhe “Vërtetimi për gjendjen bankare nuk është sipas kërkesave të DST”.

✓ Refuzimi i operatorëve të tjerë ekonomikë ka ardhur pasi sipas KVO-së “Nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar sipas DST” dhe “nuk kanë paraqitur ofertë ekonomike”.

- Me Formularin e Ankesës datë 13.08.2014, BOE “T.. line”shpk & “CEIEC” ltd, ka paraqitur ankesë pranë AK, në të cilin ka kundërshtuar skualifikimin nga gara për arsyet e cituara nga KVO, duke paraqitur dokumentacionin, për mungesën e të cilit është skualifikuar.

-Me vendimin nr. 3891/2 prot, datë 13.08.2014 të Ministrit të MAS është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për shkak të ankesës së paraqitur nga BOE “T.. I...”shpk & “C...” ltd dhe është caktuar nëpunësja zj. Zh. B për hetimin, shqyrtimin dhe dhënien e rekomandimit Titullarit të Autoritetit Kontraktor mbi zhvillimin e procedurës.

Pas shqyrtimit në tërësi të procedurës së prokurimit nga zj. Zh. B, me shkresën e datës 15.08.2014 është rekomanduar që të kualifikohen OE “M.L.” shpk (pasi u administrua dokumentacioni për inxhinierin e drurit), BOE “E.../K”shpk & “I.. S....” shpk, OE “E...” shpk dhe OE “B....” shpk dhe të skualifikohen operatorët e tjerë ekonomikë. Për BOE “T.. I...”shpk & “C....” ltd arsyet e refuzimit të ofertës sipas zj. Zh. B janë:

- “T.. I...” nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve

- Vërtetimi për gjendjen bankare nuk është në afatin e përcaktuar në DST

- OE “C.....” ltd nuk ka paraqitur listëpagesat e punëtorëve

- Kontrata e ngjashme e lidhur mes OE “C....” dhe “P... I.. INC” nuk është e shoqëruar me faturat tatimore të likuidimit të mallit.

- Pas rekomandimit të mësipërm me Vendimin nr. 6061 prot, datë 15.08.2014 Ministrja e MAS, ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës së BOE “T.. I...”shpk & “C....” ltd dhe rivlerësimin e procedurës së prokurimit, duke vijuar me përzgjedhjen e ofertës fituese (OE “M. L....” shpk).

Në Raportin Përmbledhës të datës 22.10.2014, citohet që oferta e OE “M. L...” shpk është anomalisht e ulët dhe operatori ekonomik nuk ka sjellë sqarime brenda afatit të kërkuar dhe për pasojë është skualifikuar nga KVO.

- Me Formularin e Ankesës datë 21.08.2014, BOE “T.. I...”shpk & “C....” ltd, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), në të cilin ka kundërshtuar skualifikimin nga gara për arsyet e cituara në vendimin e titullarit të AK.

- Me Vendimin nr 1478/1, datë 21.08.2014 të KPP-së është vendosur kalimi për shqyrtim i ankesës, pezullimi i procedurës së prokurimit dhe kërkesa për informacion të hollësishëm prej AK për procedurën e mësipërme, e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure.

- AK me shkresën nr. 9173/2, datë 27.08.2014 ka dërguar pranë KPP informacionin e kërkuar.

- KPP, pas shqyrtimit të ankesës së BOE “T... I...”shpk & “C....” ltd, dokumentacionit bashkëlidhur si dhe dokumenteve të dërguara nga AK, me Vendimin Nr. 519/2014, datë 12.09.2014 ka pranuar ankesën e paraqitur nga ky operator ekonomik dhe ka vendosur që AK të kualifikojë ofertën e BOE “T... I....”shpk & “C.....” ltd.

-Me shkresën Nr. 6719/1, datë 19.09.2014, Ministri i MAS i është drejtuar kryetarit të KPP z. D. B me kërkesën për rishqyrtim të vendimit nr. 519/2014, datë 12.09.2014. Në këtë shkresë janë renditur 18 mangësi, si “...argumente shtesë që vërtetojnë mospërmbushjen nga BOE

*“T. l.”shpk & “C...” ltd. të kritereve administrativo-ligjore, ekonomiko-financiare dhe tekniko-profesionale, të përcaktuar në DST”.*

- KPP, pas shqyrtimit të ankesës së AK, me Vendimin Nr. 519/3/2014, datë 06.10.2014 ka arsyetuar se *“Si përfundim, KPP gjykon se argumentet dhe kërkesa e paraqitur nga AK nuk qëndrojnë, për rrjedhojë ky i fundit duhet të zbatohet vendimin e KPP-së nr. 519/2014, datë 12.09.2014, duke kryer kualifikimin e BOE “T... l...”shpk & “C...” ltd dhe më pas të vazhdojë me hapat e tjerë proceduralë”* dhe *“KPP merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare (neni 19/1 i LPP)”*. Pas këtij arsytimi ka vendosur *“Mospranimin e kërkesës së MAS për rishikimin e vendimit 519/2014”*. Gjithashtu, sipas këtij vendimi, *“mangësitë e reja” janë evidentuar në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, pasi KVO ka detyrimin dhe të drejtën të shqyrtojë dhe vlerësojë të gjitha ofertat e paraqitura brenda afateve ligjore të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Për më tepër, LPP dhe RrPP përcaktojnë qartazi se arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë duhet të evidentohen dhe pasqyrohen në sistemin elektronik të prokurimeve.*

Me shkresën nr. 7318/1 prot, datë 09.10.2014, Ministrja e AS ka informuar KPP për zbatimin e vendimit 519/2014.

- KPP, pasi ka shqyrtuar shkresën nr. 7318/1 prot, datë 09.10.2014, sipas të cilës AK MAS e ka informuar për zbatimin e vendimit 519/2014, me Vendimin nr. 519/5/2014, datë 15.10.2014, ku palë ankimese është BOE *“T. l.”shpk & “C...” ltd* dhe objekti *“Heqje pezullimi për procedurën e prokurimit”*, ka vendosur të lejojë AK të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, pra për lidhjen e kontratës me BOE “T... l...”shpk & “C...” ltd. Me vendimin nr. 3891/3, datë 09.10.2014 Ministri i AS, ka bërë përsëri pezullimin e procedurës së prokurimit dhe emërimin e zyrtarit të autorizuar z. E. T, për shqyrtimin e ankesës së BOE *“E.../K shpk & I.-S...” shpk* të datës 08.10.2014.

Kjo ankesë është bërë për *“vendimin e gabuar të KVO-së për kualifikimin e BOE “T... l...”shpk & “C...” ltd”* dhe citon 18 argumentet e shkresës nr. 6719/1, datë 19.09.2014, me anë të së cilës Ministrja e MAS i ishte drejtuar kryetarit të KPP z. D. B me kërkesën për rishqyrtim të vendimit nr. 519/2014, datë 12.09.2014.

Me shkresën pa numër, datë 13.10.2014 zyrtari i autorizuar z. E. T, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Juridike, ka shqyrtuar ankesën dhe ka rekomanduar pranimin e ankesës së BOE “E.../K shpk & I.-S...” dhe skualifikimin e BOE “T... l...”shpk & “C...” ltd. Ky veprim, pas vendimeve të KPP-së Nr. 519/2014, 519/3/2014 dhe 519/5/2014, bie ndesh me nenin 19/1 të Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006, pika 2 sipas të cilit *“Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”* dhe nenin 64/3 *“Ankimimi në gjykatë”*, pika 1 sipas të cilit *“ Palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën përkatëse” dhe ngarkon me përgjegjësi z. E. T me cilësinë e zyrtarit të autorizuar për shqyrtimin e ankesës.*

Këtë rekomandim Ministri i MAS e ka marrë në konsideratë dhe me Vendimin nr. 3891/4 prot, datë 13.10.2014, ka vendosur të kërkojë nga KVO rivlerësimin e procedurës.

Në datën 22.10.2014, KVO ka paraqitur Raportin Përmbledhës të kësaj procedure, i cili është miratuar nga titullarja e MAS. Në këtë Raport është propozuar shpallja fitues e “E...” shpk.

Me shkresën nr.3891/6, datë 29.10.2014 është lidhur Kontrata e Furnizimit me kontraktor BOE *“E.../K shpk & I.-S...”* me vlerë totale të objektit 138,914,250 lekë pa tvsh, ose 166,697,100 lekë me tvsh.

Si përfundim, në rast se do të vlerësohej procedura sipas vendimit nr. 519/2014 të KPP, do të shpallej fitues BOE *“T... l...”shpk & “C...” ltd*, me vlerë të ofertës ekonomike 109,638,860 lekë pa tvsh dhe do të kishim një kursim në Buxhetin e Shtetit në vlerën 29,275,390 lekë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Alush Zaçe përgjegjës grupi, Selime Bregu, Ildir Dervishi, Hektor Kosova dhe Benard Haka, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Zbatimit të Standardeve dhe nga Drejtori i Departamentit.

## **KONTROLLI I LATË I SHTETIT**